

**KALLËZIM PENAL**

**KALLZUES:** Partia Demokratike Dega Fier

**ME OBJEKT:** Kallëzim i veprës penale , Neni 328 “ Dhënia e premtimeve dhe shpërblimeve”, Neni 328/a “Detyrimi për pjesmarrje në veprimtari politike”, Neni 329 “Kanosja e zgjedhësit”.

**KUNDER:** [REDAKTUAR] me detyrë [REDAKTUAR]

**DREJTUAR:** PROKURORISË Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier

*I nderuar Z. Prokuror,*

Bazuar në nenet 280, 283 dhe 75/a të K.Pr.Penale, si dhe neneve 328,328/a dhe 329 të Kodit Penal, parashtrojmë këtë kallzim penal për veprat penale të sipërcituar, duke parashtruar rrethanat e fakteve konkrete ku bazohet kallëzimi, provat me të cilat vërtetohen këto fakte si dhe dispozitat ligjore penale të cënuara.

**I. LIGJI I APLIKUESHEM**

**1.1.** Kodi i Procedurës Penale, në nenet 280, 283 dhe 75/a parashikon se:

*Neni 280*

***Marrja dijëni për veprën penale***

*Prokurori dhe policia marrin dijëni për veprën penale me iniciativën e vet dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët.*

*Neni 283*

***Kallëzimi nga ana e shtetasve***

*Çdo person që ka marrë dijëni për një vepër penale që ndiqet kryesisht duhet ta kallëzojë atë. Në rastet e caktuara me ligj kallëzimi është i detyrueshëm.*